



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 754, Datë 09.12.2020

“Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraparak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.12.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraparak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d) i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraparak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121/2003, me vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraparak në tregun e barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” vendosi:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të paraparak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore
2. Hetimi të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2019 deri në 30 nëntor 2020.
3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e vendimit.

Për vlerësimin e konkurrencës në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësorë, është kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësorë; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, informacion i cili ende nuk është depozituar.

Koha e mbetur në dispozicion për përpunimin dhe dorëzimin e raportit është e pamjaftueshme,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 707 datë 23.09.2020 “Për hapjen e Hetimit Paraprak në Tregun e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 janar 2021”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS